

A keni ndonjë aftësi të kufizuar?



A keni nevojë për ndihmë për të aplikuar për strehim ose për të aksesuar vendndodhjet e qendrave të strehimit?

Ne mund të ofrojmë disa lloj ndihmash për ta bërë më të lehtë për ju aksesin në shërbimet që ju nevojiten. Kjo lloj ndihmë quhet akomodim i arsyeshëm. Ju gëzoni të drejtën ta kërkonti këtë lloj ndihme.

Disa shembuj të gjendjeve që mund ta bëjnë të vështirë aksesin në shërbimet që ju nevojiten janë:

- Vështirësi në shikim, të folur apo të dëgjuar
- Vështirësi në lëvizje (aftësi të kufizuara që e bëjnë të vështirë lëvizjen)
- Vështirësi në procesin njohës (aftësi të kufizuara që mund ta bëjnë të vështirë kuptimin e formularëve ose mbajtjen mend të takimeve)
- Gjendje të shëndetit mendor si ankth, depresion, çrregullim bipolar ose skizofreni

Si mund të kërkoj një akomodim të arsyeshëm?

- Mund të kërkonti ndihmë për shkak të një aftësie të kufizuar nga stafi në çdo qendër për pranim, vlerësim apo strehim.
- Ju mund ta plotësoni Formularin e Kërkesës për Akomodim të Arsyeshëm (**DHS-13**).
- Nëse ju nevojitet një formular me shkronja të mëdha ose në një gjuhë tjetër, mund të vizitoni faqen e internetit të Departamentit të Shërbimeve për Personat e Pastrehë (Department of Homeless Services, DHS) ose t'i kërkonti ndihmë një anëtar të stafit të DHS-së ose qendrës së strehimit.
- Mund t'i merrni këto formularë në internet: <https://www1.nyc.gov/site/dhs/about/applicants-and-clients-with-disabilities.page> ose t'ia kërkonti stafit formularët.
- Nuk keni nevojë t'i plotësoni këto formularë për të kërkuar një akomodim të arsyeshëm. Stafi mund t'i plotësojë formularët për ju.

Ku mund ta dorëzoj një formular Kërkese për Akomodim të Arsyeshëm (RAR) ose një kërkesë me shkrim për një akomodim?

- Jepjani formularin e plotësuar të kërkesës ose kërkesën me shkrim stafit të DHS-së apo të qendrës së strehimit.
- Kërkonti një kopje të kërkesës suaj të plotësuar ose një dëftesë.
- Shkruani datën kur ia keni dhënë kërkesën DHS-së ose stafit të qendrës së strehimit dhe emrin e personit të cilit ia dhatë atë në kopjen tuaj.
- Nuk keni nevojë të na jepni prova për gjendjen ose aftësinë tuaj të kufizuar në kohën e kërkesës. Ne mund t'ju kërkojmë më vonë që të na jepni disa dokumente ose informacione shtesë që lidhen me kërkesën tuaj.

Po nëse më duhet ndihmë me plotësimin e formularëve?

- Mund t'i kërkonti ndihmë stafit të DHS-së, stafit të qendrës së strehimit ose dikujt që njihni për plotësimin e këtyre formularëve.

Si do ta zbuloj nëse kërkesa ime është miratuar?

- Do t'ju dërgojmë një njoftim dhe do t'ju njoftojmë për vendimin tonë.

Po sikur të kem pyetje lidhur me kërkesën time ose nevoja të tjera që lidhen me aftësitë e kufizuara?

- Mund të flisni me drejtorin e qendrës së strehimit ose menaxherin e rastit tuaj nëse keni pyetje.
- Gjithashtu mund të kontaktoni Zyrën e Çështjeve të Aftësive të Kufizuara në DisabilityAffairs@dss.nyc.gov

Politika kundër diskriminimit

Po sikur ta ndiej që jam trajtuar padrejtësisht për shkak të aftësisë sime të kufizuar?

- Nëse besoni se DHS-ja ju ka mohuar juve ose dikujt në familjen tuaj shërbimet ose ju ka diskriminuar për shkak të një aftësie të kufizuar, mund të kontaktoni:

Office of Disability Affairs
150 Greenwich Street, 42nd Floor
New York, NY 10007
Faks: (917) 639-0442
Ueb: disabilityaffairs@dss.nyc.gov

Gjithashtu mund të kontaktoni numrin unik të DSS në **(718) 557-1399**.

Përveç kësaj, mund të kontaktoni edhe Zyrën e Avokatit të Popullit në numrin **(800) 994-6494** ose ta vizitoni personalisht zyrën në adresën 109 East 16th Street, nga e hëna në të premte nga ora 9:00 deri në 16:00.

Çfarë informacioni duhet të përfshij nëse bëj një ankesë?

- Emrin, adresën postare, numrin e telefonit ose adresën e email-it tuaj.
- Një përshkrim të asaj që ka ndodhur, ku ka ndodhur dhe kur ka ndodhur.
- Emrat dhe titujt e pozicionit të punës së stafit të përfshirë, nëse i keni.
- Vendndodhjen, programin ose shërbimin e DHS-së ose qendrës së strehimit të përfshirë.

DHS-ja është e angazhuar për të siguruar për personat me aftësi të kufizuara, akses kuptimplotë në programe dhe shërbime në përputhje me Aktin Amerikanët me Aftësi të Kufizuara (ADA) të vitit 1990 dhe ligje të tjera.